




Suksesi i një shkollimi, varet shumë nga suksesi i komunikimit në mes të mësimitdhënësit dhe nxënësit.

Mjetet arsimore, në këtë rast, paraqesin „ndërmjetës shtesë“. Ato duhet të jenë të përshtatshme, njohuritë mbi gjëra apo gjendjen faktike duhet ti ndërmjetësojnë në mënyrë ilustrative, të qartë, të kuptueshme dhe të paharrueshme. Gjatë përzgjedhjes së mjeteve arsimore, gjithnjë duhet të mendojmë, se si do ta arrijmë më së miri qëllimin e mësimit dhe do ta zgjojmë interesimin e nxënësve, në mënyrë që të sigurojmë suksesin e mësimit.

*Nga puna dhe biseda ime, mua më është e njohur se niveli i të pajisurit me mjete arsimore në shkollat profesionale ndryshon shumë. Në disa shkolla nuk ka bile asnjë Overheadprojektor, ndonëse mjetet (financiare) për të janë prezente!*

### Mjetet arsimore ilustruese



Në kuadër të këtyre gjësendeve mjaft efikase në aplikim, bëjnë pjesë edhe mjete shumë të thjeshta, si p.sh. materiale apo prodhime pune me defekte që janë ndarë dhe mund të përdoren vetëm për demonstrim.

- Makina dhe pajisje me konstrukcion të thjeshtë që mund të përdoren si objekte për vrojtim
- Punë të sukseshme të nxënësve, p.sh. rezultatet e ndonjë projekti pune, që mund të përpunohen edhe për një kohë të gjatë

Sidomos në shkolla ku ende nuk zhvillohet shkollimi praktik profesional, punohet shpesh me modele dhe riprodhime. Mund të jenë plotësues të mirë dhe mund të përdoren p.sh. kur diçka jo mirë e kuptueshme (shumë e madhe apo shumë e vogël), të bëhet e kuptueshme për nxënësit.

Gjithnjë e më shpesh nëpër shkolla formohen kabinete kompjuterike të pajisura mirë dhe gjithnjë e më tepër po zbatohet mësimi i bazuar në kompjuter.

Edhe përkundër këtij zhvillimi pozitiv, mediami më i vjetër i mësimit teorik dhe praktik - TABELA (dërrasa e zezë) - ende e ka vlerën e saj:

- Puna në tabelë duhet planifikuar me kujdes, nuk guxon assesi ti lihet rastit.
- Duhet planifikuar hapësirën që na duhet, në mënyrë që shënimet në tabelë të jenë të kapshme për sy
- Zhvillim gradual i tablos, në mënyrë që ti jipen nxënësit paraprakisht informatat lidhur me hapsirën dhe ndarjen e duhur të fletëve
- Punoni me ngjyra dhe nënvizime të ndryshme
- Vizatimet e mëdha do të duhej të vizatoheshin në tabelë para fillimit të orës, në mënyrë që të kursehet koha e vlefshme

Në shumë shkolla punohet me sukses me Overheadprojektor-in. Në shumë lëndë me anë të folieve, mund të bëhet prezantimi ilustrativ, i kuptueshëm, i vizatimeve, tabelave, dhe i diagrameve.

Në këtë mënyrë bëhet i mundur prezantimi gradual i hapave të punës, njëri pas tjetrit, duke vendosur foliet me rradhë, hap pas hapi.

Mirëpo hospitimet tregojnë se gjatë punës me Overheadprojektor ende bëhen gabime të shumta:

- Keni kujdes që gjatë shkrimit apo vizatimit, të mos mbulohet fotoja projektuese nga trupi i juaj
- Gjatë ligjërimit apo zhvillimit të hapave të punës është më mirë që teksti, respektivisht prezentimet në folie të zbulohen hap pas hapi, në mënyrë që nxënësi të mund të koncentrohet në një pjesë të tekstit e të mos „stërngarkohet nga tërë teksti“

Puna për prezentimin e problemeve me anë të flipchart-it, në grupe të vogla mund të jetë e dobishme.



*Pas këtij pasqyrimi mua më mbetët vetëm të them se, pasuria ideore dhe kreativiteti i mësimdhënësit, dhe nxënësit nuk kanë kufinj. Paramendoni se çka mund të përgatitni prej materialeve të thjeshta e jo të shtrenjta (stiropor, letër, karton, gazetë, revistë).*